



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.550/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarin Hajriz Hoti, e me zyrtare ligjore, Vjosa Iseini, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, N.H., nga fshati S., Komuna e V., të cilin me autorizim e përfaqëson, I.S., kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, për shkak të njohjes së të drejtës për Pensionin për Persona me paaftësi të përhershme, në seancën e shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit dhe në mungesë të paditurës, më datë;18.12.2018, merr këtë,

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, N.H., nga fshati S., Komuna e V., anulohet aktvendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, me numër të dosjes 5083315 i dt.16.01.2017, si dhe vendimi në shkallë të parë i dt.02.06.2014 dhe paditësit i njihet e drejta në Pensionin për Persona me paaftësi të përhershme, në kohëzgjatje prej 5 vitesh dhe atë nga data;02.06.2014, e deri me dt.16.01.2018.

II. Detyrohet e paditura, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale, që paditësit në mënyrë retroaktive t'ia kompensoj pagesat për Pensionin për Persona me Aftësi të Kufizuar nga dt.02.06.2014, për çdo muaj shumë prej 75 euro, deri në pagesën definitive, krejtë këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nën pasojat e përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, e në mungesë të paditurës e thirrur në mënyrë të rregullt.

I autorizuari i paditësit I.S. në seancën e shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, dhe i propozon gjykatës që e njëjta të aprovohet në tersi si e bazuar, për faktin se e paditura gabimisht ka vërtetuar gjendjen kur ka refuzuar ankesën e dt.08.05.2014, nga të gjitha këto të thëna dhe prova të paraqitura në padi kërkojmë nga gjykata që pas administrimit të provave të bën aktgjykim dhe ti i njihet e drejta për pension për personat me aftësi të kufizuara të paditësit, njherit poashtu i kërkojmë se paditësi nga viti 2011 e këtej ka qenë i përjashtuar nga skema pensionale me arsyetimin se i njëjti nuk i plotëson kushtet e parapara ligjore për pension me aftësi të kufizuara për çka ne i kundërshtojmë vendimet e komisioneve të caktuara nga Ministria për çka e vërteton edhe Ekspertiza mjekësore e caktuar nga gjykata, i kërkojmë gjykatës po ashtu që paditësit ti kompensohen pagat si formë në kthimin e gjendjes së më parshme.

Përfaqësuesi i të paditurës në përgjigjen e dhënë në padi me dt.23.04.2018, ka theksuar se vendimi i atakuar është i bazuar dhe pretendimet e palës paditëse për shkelje ligjore nuk qëndrojnë, për arsye se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi, ashtu që pretendimet e veta, pala paditëse nuk i ka vërtetuar me asnjë provë. MPMS i ka

propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses në tërësi si të pabazuar.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor dt.18.12.18 ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi i dt.16.01.2016, raportet e dt.08.03.2017, dt.20.03.2017, raporti i dt.20.03.2017, aktgjykimi i kësaj gjykate dt.09.11.2016, vendimet e dt.15.10.2008, dt.22.04.2008, dt.22.01.2007, përgjigja në padi e dt.23.04.2018, vendimi i dt.18.02.2014, raporti i mjekut i lëshuar nga Fakulteti i Mjekësisë i dt.22.12.1986, vlerësimet e dt.15.05.2014, dt.14.02.2014, dt.22.12.2016, aktvendimi i dt.30.11.2011, ekspertiza e QKUK-së e dt.26.11.2018, si dhe raporti i radiologut i dt.05.10.2015.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimeve të goditura me padi, në përputhje me nenin 44.3 dhe nenit 67 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga vendimet e kontestuara rrjedhin se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 48 të këtij ligji është paraparë se “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar.

Vendimet e të paditurës të dt.16.01.2017 dhe të dt.02.04.2014, janë juridikisht të paqarta dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tyre. Në arsyetimet e tyre nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimeve të kundërshtuara. Në arsyetimin e vendimit kontestues është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se, “Këshilli i ankesave si organ i shkallës së dytë e ekspert mjekësor të lëmive përkatëse duke vepruar sipas ankesës të z/znj N.H. në seancën e dt.22.12.2016, ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor, vlersimin e komisionit mjekësor të shkallës së dytë në përputhje me nenin 9 të PAK, dhe ka konstatuar-vlerësuar se nuk ka dokumentacion mjekësor të mjaftueshëm për të qenë përfituese e pensionit për persona me pa aftësi të përhershme, prandaj Komisioni Mjekësor i shkallës së dytë pajtohet me vlerësimin e komisionit të shkallës së parë që nuk janë plotësuar kriteret e parapara me ligj”.

Me vendimet e të paditurës të dt.22.01.2007, dt.22.04.2008, gjykata vëren se, paditësit i është njohur e drejta në Pensionin për Persona me aftësi të Kufizuara, në shumë prej 40 euro për muaj, për periudhën kohore prej 1 viti, poashtu me vendimin e dt.15.10.2008, paditësit i është njohur e drejta në Pension për Persona me aftësi të Kufizuara, në shumë prej 40 euro për muaj, për periudhën kohore prej 3 vite.

Kjo gjykatë pas administrimit të provave si me lart, pasi i ka vlerësuar një nga një provat i fali besimin raporteve mjekësore të paditësit, vendimit të paditurës të dt.15.10.2008, me të cilin paditësit i është njohur kjo e drejtë në Pensionin për Persona me aftësi të Kufizuara,

për periudhën kohore për 3 vite e në veçanti ekspertizës të nxjerrur sipas detyrës zyrtare nga Gjykata për paditësin me dt.26.11.2018, në përbërje prej tre (3) profesionisteve të fushave përkatëse, të caktuar për këtë ekspertizë, të cilët pasi kanë ekzaminuar pacientin dhe shkresat tjera të lëndës kanë nxjerrë përfundim; se te paditësi konstatohet lëvizjet në të dyja nyjet rrotulluese janë të bllokuara dhe shtyllën te kurizit e ka vështirë për kuljen dhe nuk mund të përkulet komplet, ku ekziston invaliditeti i rëndë trupor, gjendje definitive i pa aftë për çdo lloj pune. Po ashtu, kjo gjykatë ka vlerësuar si provë edhe raportet e dt.20.03.2017, dt.22.12.1986, ku është konstatuar pa aftësia për punë e pacientit. Ndërsa nga shkresat e lëndës, shihet dhe vërtetohet se gjendja e tij shëndetësore nuk ka ndryshuar dhe këtë fakt e vërtetoj dhe ekspertiza e QKUK-së, e nxjerrë në procedurën gjyqësore dhe nga të gjitha këto arsye, kjo gjykatë nuk mundi të falë besimin mendimit dhe konstatimit të Komisionit Mjekësor të paditurës, si provë e vetme e që vërteton se paaftësia e përhershme, tek paditësi nuk ekziston dhe atë pas tre viteve pasi që i është njohur e njëjta e drejtë. Nga provat e vërtetuara me lart kjo Gjykatë i ka njohur këtë të drejtë paditësit për periudhën kohore nga ndërprerja e pensionit në rivlerësim.

Nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata vërtetoj se N.H., është person me paaftësi të përhershme dhe në përputhje te nenit Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht nenit 9, paragrafet 1 dhe 5 të të njëjtit, ku përcaktohet se “Pensioni i paaftësisë të përhershme do t’iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse: ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore; Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës; Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh; Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nënparagrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor.”

Kjo gjykatë vlerësoj dhe pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi mirëpo, të njëjtat pretendime i vlerëson si të pa bazuara, nga fakti se nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor është vërtetuar se paditësi i plotëson kërkesat e ligjit për njohjen e të drejtës së kërkuar.

Lidhur me lartësinë e pensionit, gjykata u bazua në vlerën e caktuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/176, të dt.10.03.2014, ku lartësia e këtij pensioni është 75 euro për muaj.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43.3, 46.2, 5 lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe 67 Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 9 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.550/2017, dt.18.12.2018,

Zyrtare Ligjore
Vjosa Iseini

G j y q t a r i
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita te marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.